



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pika 1, shkronja “g”, dhe 3 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor.

Neni 98, pika 1 ka parashikuar kompetencën e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, është përgatitur projektvendimin “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, ka për qëllim të përcaktojë specifikimet teknike të fletëve të votimit që do të përdoren për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Neni 97, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë. Pika 3/1 e këtij neni përcakton që ngjyra e fletës në zgjedhjet e qeverisjes vendore, është e njëjtë në të dyja anët e saj.

Referuar nenit 98 të Kodit Zgjedhor, fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë.

Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elementë teknikë në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si dhe elementë të tjerë identifikues që nuk lexohen me sy të lirë (barcode). Elementët e sigurisë dhe elementët teknikë janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr. 1 dhe nr. 2 që i bashkëlidhen projektvendimit dhe që së bashku me modelet, përbëjnë pjesën integrale të tij.

Komisioni Rregullator nuk mund të shprehet në mënyrë shteruese për dimensionet e fletëve të votimit, e për këtë arsye propozohet që me këtë vendim të miratohen dimensionet minimale të tyre. Në tekstin e projektvendimit, është përcaktuar se përmasat e fletës së votimit mund të ndryshohen, në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen në zgjedhje brenda afatit ligjor.

Duke qenë se tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar për specifikimet e fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, referuar edhe vendimeve nr. 104, datë 09.04.2015 dhe nr. 11, datë 18.01.2019, i ndryshuar, propozohen specifikimet në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të projektvendimit.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI